NOVAMAT SHPK

NIPT: K81615120

Pasqyrat financiare te audituara

Per ushtrimin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2014

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

E & B Auditing shpk
Rr.I. Alla. P. Alba Flor Nr. 17
Tirane, Albania
Email:elza@ebauditing.al
Tel/Fax 042424073

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

Ortakëve të shoqërisë "NOVAMAT" shpk
Kashar, Mezez, Autostrada Tirane-Durres, Km 1,
Rruga "Pavarsia", Objekti Nr.71.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkalidhur të shoqerise "Novamat" (Shoqëria), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i datës 31 Dhjetor 2014, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet, dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin ushtrimor të mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje të metodave të rëndësishme kontabël dhe shenimeve të tjera anekse.

Përgjegjësia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që në të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë ketu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlërson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi perfshin vlerësimin e parimeve kontabile të përdorura dhe të cmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi jep një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të shoqërisë japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të subjektit "Novamat" shpk me 31 Dhjetor 2014, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave, për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar.

E & B Auditing

Elza Balla

26 Mars 2015

E & B AUDITING Sh.p.k
L01409001J
Tirana-Albania

PERMBAJTJA:

BILANCI ME 31 DHJETOR 2014		2
PASQYRA E TE ARDHURAVE		3
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE		4
PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITALET E VETA		5
1.	**INFORMACION I PERGJITHSHEM**	**6**
2.	**PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE**	**6**
4.	**MJETE MONETARE**	**9**
5.	**AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFAT-SHKURTRA**	**9**
6.	**INVENTAR**	**9**
7.	**AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**	**10**
8.	**HUATE DHE DETYRIMET AFATSHKURTRA**	**10**
9.	**SHITJET NETO**	**11**
10.	**KOSTO MATERIALE**	**11**
11.	**KOSTO E PUNES**	**11**
12.	**FURNITURA DHE SHERBIME**	**11**
13.	**FITIME/(HUMBJE) NGA KEMBIMET VALUTORE**	**12**
14.	**TATIM FITIMI**	**12**

"Novamat" Shpk

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

BILANCI ME 31 DHJETOR 2014
(Gjithe vlerat ne Leke)
Bilanci

	Shenime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktivet			
I. Aktivet afatshkurtra			
1. Mjete monetare	4	**28,004,910**	**16,106,771**
2. Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim			
3. Inventari	5	7,192,043	11,923,448
4. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		-	-
5. Aktive te tjera financiare	6	26,570,527	7,115,914
Totali i aktiveve afatshkurta (I)		**61,767,480**	**35,146,133**
II. Aktivet afatgjata			
1. Investime financiare afatgjata			
2. Aktive afatgjata material	7	**5,339,240**	**5,232,892**
3. Aktive afatgjata jomateriale		-	-
4. Aktive te tjera afatgjata			
Totali i aktiveve afatgjata (II)		**5,339,240**	**5,232,892**
Totali i aktiveve (I + II)		**67,106,720**	**40,379,025**
Detyrimet dhe kapitali			
I. Detyrimet afatshkurtra			
1. Derivativet			
2. Huat afatshkurta		-	-
3. Detyrimet per t'u paguar dhe paragimet	8	54,104,282	30,700,421
4. Grantet dhe te ardhurat e shtyra		-	-
5. Provizionet afatshkurta			
6. Detyrime te tjera afatshkurtra			
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		**54,104,282**	**30,700,421**
II. Detyrimet afatgjata			
1. Huat afatgjata			
2. Provizionet afatgjata			
3. Grantet dhe te ardhurat e shtyra		-	-
4. Detyrime te tjera afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		-	-
Totali i detyrimeve (I + II)		**54,104,282**	**30,700,421**
III. Kapitali			
1. Kapitali aksioner		1,300,000	1,300,000
2. Rezervat statutore dhe ligjore		-	-
3. Fitimet (humbjet) e akumuluara		8,378,604	5,400,000
4. Fitimi (humbja) e vitit		3,323,834	2,978,604
Totali i kapitalit (III)		**13,002,438**	**9,678,604**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I + II + III)		**67,106,720**	**40,379,025**

Bilanci duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.
Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u pergatiten nga Ajet Cenollari, u aprovuan nga Mehmet Krasniqi me 25.03.2015 dhe u nenshkrua si me poshte

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Novamat
Shpk

PASQYRA E TE ARDHURAVE
(Gjithe vlerat ne Leke)

	Te Ardhura & Shpenzime	Sheni me	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2013
1	**Shitjet neto**	**9**	**90,493,607**	**98,808,016**
2	**Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit**	**9**	**8,858,617**	**6,189,940**
3	**Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gatshme dhe ne proces**		-	-
4	**Materialet e konsumuara**	**11**	**(83,237,087)**	**(89,086,215)**
5	**Kosto e punes**	**12**	**(4,721,791)**	**(6,009,559)**
5.1	Paga e personelit		(4,150,778)	(5,654,120)
5.2	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore		(571,013)	(355,439)
6	**Amortizimi dhe zhvleresimet**		**(979,349)**	**(618,000)**
7	**Shpenzime te tjera**	**13**	**(6,410,803)**	**(5,779,321)**
8	**Totali i shpenzimeve**		**(95,349,030)**	**(101,493,095)**
9	**Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore**		**4,003,194**	**3,504,861**
10	**Te ardhura dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrollit**		-	-
11	**Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet**		-	-
12	**Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga:**		**(92,801)**	**(113,612)**
12.1	Investime te tjera financiare afatgjate			
12.2	Interesa		-	(12,494)
12.3	Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit		195,841	(101,118)
12.4	Te tjera financiare		(288,642)	-
13	**Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare**	**14**	**(92,801)**	**(113,612)**
14	**Te ardhura e shpenzime te pacaktuara**		-	-
15	**Fitimi(humbja) para tatimit**		**3,910,393**	**3,391,249**
16	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**	**15**	(586,559)	(412,645)
17	**Fitimi (humbja) neto e vitit financiar**		**3,323,834**	**2,978,604**
18	**Elementet e pasqyrave te konsoliduara**			

Bilanci duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.
Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u pergatiten nga Ajet Cenollari, u aprovuan nga Mehmet Krasniqi me 25.03.2015 dhe u nenshkrua si me poshte

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Novamat
Shpk

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE
(Gjithe vlerat ne Leke)

Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	**2014**	**2013**
Fitimi para tatimit	3,910,393	3,391,249
Korrigjime per:		
Amortizimin	979,349	618,000
(Fitim)/ Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	0	0
Prodhimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
Shpenzime per interesa	0	0
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave per arketim	(19,454,613)	18,025,219
Rrite/renie ne tepricen e inventarit	4,731,405	(3,731,602)
Rrite/renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar	23,403,861	(8,709,245)
Fluksi i parave te perfituara nga aktivitetet	***13,570,395***	***9,593,621***
Interes i paguar	0	0
Tatim fitimi i paguar	(586,559)	(412,645)
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit	**12,983,836**	**9,180,976**
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(1,085,697)	(3,355,200)
Te ardhura nga shitja e aktiveve material	0	1,000,931
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata material	-	-
Fluksi monetar neto nga veprimtaria investuese	**(1,085,697)**	**(2,354,269)**
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financiare		
Rritja/ (renia) neto e mjeteve monetare	**11,898,139**	**6,826,707**
Mjetet monetare ne fillim te periudhes	16,106,771	9,280,064
Mjetet monetare ne fund te periudhes	**28,004,910**	**16,106,771**

Bilanci duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.
Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u pergatiten nga Ajet Cenollari, u aprovuan nga Mehmet Krasniqi me 25.03.2015 dhe u nenshkrua si me poshte

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Novamat
Sh.p.k

PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITALET E VETA
(Gjithe vlerat ne Leke)

	Kapitali aksioner	Rezerva	Fitim Humbje e vitit	Fitime te mbartura	Total
1 Janar 2013	**1,300,000**	-	-	**5,400,000**	**6,700,000**
Fitim humbje e vitit	-	-	2,978,604	-	**2,978,604**
Rritje e kapitalit		-		-	-
Zvogelim kapitali	-	-		-	-
Transferim	-	-	-	-	-
FX differences		-		-	-
Divident I shperndare	-	-		-	-
31 Dhjetor 2013	**1,300,000**	-	**2,978,604**	**5,400,000**	**9,678,604**
1 Janar 2014	**1,300,000**	-	**2,978,604**	**5,400,000**	**9,678,604**
Fitim humbje e vitit	-	-	-	3,323,834	**3,323,834**
Rritje e kapitalit		-		-	-
Zvogelim kapitali	-	-		-	-
Transferim	-	2,978,604	(2,978,604)	-	-
FX differences		-		-	-
Divident I shperndare	-	-		-	-
31 Dhjetor 2014	**1,300,000**	**2,978,604**		**8,723,834**	**13,002,438**

Bilanci duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.
Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u pergatiten nga Ajet Cenollari, u aprovuan nga Mehmet Krasniqi me 25.03.2015 dhe u nenshkrua si me poshte

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Novamat
Sh.p.k

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria **"NOVAMAT"** eshte rregjistruar prane QKR me date 11.03.2008, Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj aktualisht ne Tirane, Autostrada Tirane-Durres,Km.1 Kashar,Mezes,Komuna Ysberisht Tirane ku ka edhe seline.

Shoqeria e ushtron aktivitetin e vet ne fushen investimit ne energjetike, telekomunikacione, makineri e mallra te ndryshme.
Ortake te kuotave te kapitalit te nenshkruaar jane:

	Emri i aksionerit	Vlera e kapitalit te nenshkruar ne LEK	% ne kapital
1	Mehmet Krasniqi	650.000	50 %
2	Novamat Industriewarenhandels-gesellschaft	650.000	50%

Administrator i shoqerise eshte z. Mehmet Krasniqi.
Me 31 Dhjetor 2014 shoqeria kishte 5 punonjes (31 Dhjetor 2013: 4 punonjes).

Shoqeria eshte regjistruar si person juridik ne rrethin e Tiranes me NIPT K81615002O.

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 jane miratuar nga Drejtori i shoqerise me 25 Mars 2015.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Paqyrat financiare jane pergatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perbehen nga regullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Paqsyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqerise.

b. Aktive e afatgjata materiale dhe jomateriale

(i)Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.
Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Quality and Safety from one source NOVAMAT Sh.p.k Tirane - Albania

Novamat Shpk

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii)Kostot e mëpasshme
Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (vazhdim)

(iii) Amortizimi
Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jeten e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar per periudhën aktuale bazuar ne udhezimin e Ministrise se Financave nr. 1 date 11.01.20102 si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

Aktivet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe te perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme.

c. Inventari

Inventaret jane paraqitur ne pasqyrat financiare te Shoqerise duke perdorur vleren e blerjes se tyre qe eshte me e vogel se vlera neto e realizueshme. Per inventarizim shoqeria ka perdorur metoden periodike.

d. Llogarite e arketueshme dhe llogarite e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e. Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat ne Lek dhe ne monedha te huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

f. Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (vazhdim)

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
1 EUR	140.14	140.20
1 USD	115.23	101.85

g. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

h. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri per vitin 2014.

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Novamat Shpk

i. Fondet per pensione

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurim shendetsor per punonjesit e saj sic eshte parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetsore. Nuk ka asnje detyrim tjeter ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendesore.

j. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

4. MJETE MONETARE

Arkat dhe bankat më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë përbërë si me poshtë:

	2013	2012
Llogari ne leke	-	-
Llogari ne monedhe te huaj	28,004,910	16,106,771
Arka	-	-
	28,004,910	**16,106,771**

5. AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFAT-SHKURTRA

Aktivet afat-shkurtra më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë përbërë si më poshtë:

	2014	2013
Kliente	24,630,000	6,528,832
Parapagime Tatim fitimi	74,339	7,911
TVSH	1,866,188	579,171
	26,570,527	**7,115,914**

6. INVENTAR

Inventari më 31 dhjetor 2014 është i përbërë nga ;

	2014	2013
Mallra	7,192,043	11,923,448
	7,192,043	**11,923,448**

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Novamat Shpk

7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afat-gjata materiale më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë përbërë si më poshtë:

	Pajisje kompjuterike	Mjete transporti	Pajisje zyrash	Totali
Kosto 1 Janar 2013	759,732	2,667,916	356,870	3,784,518
Vlera		3,355,200	-	3,355,200
Shtesa	-	(1,000,931)	-	(1,000,931)
Pakesime		-		-
Vlera 31 Dhjetor 2013	759,732	5,022,185	356,870	6,138,787
Kosto 1 Janar 2014				0
Vlera	759,732	5,022,185	356,870	6,138,787
Shtesa	-	1,085,697	-	1,085,697
Pakesime		-		-
Vlera 31 Dhjetor 2014	759,732	6,107,882	356,870	7,224,484
Amortizimi 1 Janar 2013	(103,957)	(157,328)	(26,610)	(287,895)
Amortizimi I vitit	(330,105)	(221,843)	(66,052)	(618,000)
Pakesime	-	-	-	-
Amortizimi 31.12.2013	**(434,062)**	**(379,171)**	**(92,662)**	**(905,895)**
Amortizimi 1 Janar 2014	(434,062)	(379,171)	(92,662)	(905,895)
Amortizimi I vitit	(81,418)	(845,089)	(52,842)	(979,349)
Pakesime	-	-	-	-
Amortizimi 31.12.2014	**(515,480)**	**(1,224,260)**	**(145,504)**	**(1,885,244)**
Vlera Neto 31.12.2013	**325,670**	**4,643,014**	**264,208**	**5,232,892**
Vlera Neto 31.12.2014	**244,252**	**4,883,622**	**211,366**	**5,339,240**

8. HUATE DHE DETYRIMET AFATSHKURTRA

Huatë dhe parapagimet më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë përbërë si me poshtë:

	2014	2013
Furnitore	53,968,828	30,469,044
Detyrime per sigurime shoqerore	90,792	61,947
Detyrime per tatime	44,662	169,430
	54,104,282	**30,700,421**

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

9. SHITJET NETO

Shitjet neto jane si me poshte:

	2014	2013
Te ardhura nga veprimtaria e zakonshme	90,493,607	98,808,016
Te ardhura Export	8,858,617	6,189,940
	99,352,224	**104,997,956**

10. KOSTO MATERIALE

Materialet e konsmuara

	2014	2013
Mallra	83,237,087	89,086,215
	83,237,087	**89,086,215**

11. KOSTO E PUNES

Kosto e personelit eshte si me poshte:

	2014	2013
Pagat e personelit	4,150,778	5,654,120
Sigurime shoqerore	571,013	355,439
	4,721,791	**6,009,559**

12. FURNITURA DHE SHERBIME

Shpenzime te tjera paraqiten si me poshte:

	2014	2013
Qira	945,000	840,000
Kancelari	991,012	336,232
Mirembajtje dhe riparime	554,708	19,716
Udhetime e dieta	577,415	392,274
Shpenzime per automjete	205,247	454,203
Shpenzime Postare,Tel,Internet,Celulare	739,250	
Siguracione	859,269	683,173
Sherbime bankare	287,451	257,314
Te trete Juridike financiare	466,667	391,667
Taksa vendore, doganor	199,816	238,717
Pritje percjellje	140,756	175,200
Gjoba dhe penalitete	-	735,200
Te tjera	444,212	1,255,625
	6,410,803	**5,779,321**

Quality and Safety from one source NOVAMAT Sh.p.k Tirane - Albania

Novamat Shpk

13. FITIME/(HUMBJE) NGA KEMBIMET VALUTORE

	2014	2013
Te ardhura nga interesat e fituara nga depozitat		
Interesa bankare		12,494
Te ardhura financiare	-	**12,494**
Te tjera shpenzime bankare	(288,642)	
Humbje neto nga kembimet valutore	195,841	101,118
Shpenzime financiare	**(92,801)**	**101,118**
Shpenzime financiare neto	**(92,801)**	**113,612**

14. TATIM FITIMI

Bazuar ne legjislacionin shqipëtar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2014.Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregulloret shqipëtare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	2014	2013
Humbje e mbartur	0	0
Fitimi (Humbja) perpara tatimit	3,910,393	3,391,249
Shpenzime te pazbritshme per efekt tatim fitimi	0	735,200
Fitimi i tatueshem	3,910,393	4,126,449
Tatimi mbi fitimin (15%)	**586,559**	**412,645**

PER SHOQERINE "NOVAMAT" SHPK

Mehmet Krasniqi
ADMINISTRATOR

Mehmet Krasniqi

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania

Ajet Cenollari
KONTABILIST

Notere Majlinda E.Demollari
Dhoma e Noterise Tirane
Rr" V. Pasha"
Tel ++269948
Nr 3681 **Rep**
Nr---------- **Kol**
1697

KONTRATE QERAJE

Sot ne date 01.06.2012 (dymije e dymbedhjete) ne Zyren e Noterise, para meje Noteres Majlinda E.Demollari u paraqiten personalisht palet si me poshte te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote kerkuan redaktimin e kontrates se qerase si me poshte ne mbeshtetje te neneve 801 e vijues te K.C:

QERADHENESI:

Ylli Stojku, i datelindjes 05.11.1961, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. 025904081.

QERAMARRESI:

Shoqeria " Novamat" shpk e regjistruar ne organet tatimore perfaqesuar nga Mehmet Krasniqi, i datelindjes 14.08.1973, lindur ne Prishtine dhe banu*es ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me pashaporte me nr . K00150716.*

OBJEKTI I KONTRATES

NENI 1

Qeradhenesi eshte pronar i nje apartamenti me nr. 2 ne Rr" I Qemali" pall Fratarit shpk me siperfaqe 129.7 m2 e regjistruar ne ZRPP Tirane ne ZK 8270, me pasuri me nr. 3/100.

Pronesine per pronen e mesiperme qeradhenesi e verteton me dokumentat e pronesise. Pronen e mesiperme qeradhenesi ia jep me qera qeramarresit .

AFATI I QERASE

NENI 2

Kjo kontrate qeraje lidhet per nje afat tre vjecar duke filluar nga data 15.05.2012 deri ne date 15.05.2015 me te drejte riperteritje te menjehershme me marreveshje midis tyre .

QERAJA

NENI 3

Qiraja qe do te paguaje qiramarresi ne favor te qiradhenesit per objektin e pershkruar ne kete kontrate do te jete 500 Euro (peseqind) ne muaj e cila do te likujdohet paradhenie cdo date 15-20 te muajit . 10% tatim burimi e merr persiper pala qeramarrese .

MENYRA E LIKUJDIMIT TE QIRASE

NENI 4

Qiraja ne masen e parashikuar ne nenin 3 do te paguhet nga qeramarresi ne kete menyre: Qeraja do ti paguhet qeradhenesit ne dore ose me llogari bankare.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E QERADHENESIT

NENI 5

Qeradhenesi menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate duhet te dorezoje ambientin ne gjendjen aktuale te dorezimit .Qeradhenesi garanton qeramarresin nga

cdo cenim apo pretendim qe mund te vije nga persona te trete perfshire edhe pretendime pronesie dhe mban pergjegjesi per pronen qe e jep me qera .Qeradhenesi eshte e detyruar ti pergjigjet organeve perkatese ne lidhje me rregullsine e dokumentacionit te prones dhe merr persiper te zgjidhe cdo problem qe mund te linde Shpenzimet e mirembajtjes se ambientit te perbashket me banoret e tjere do te perballohen nga pala qeradhenese.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QERAMARRESIT

NENI 6

Qeramarresi pas marrjes ne dorezim te ambientit sipas proces verbalit ka te drejte ta perdore ate lirisht sipas aktivitetit Qeramarresi eshte i detyruar te paguaje qerane ne masen dhe afatin e parashikuar ne kete kontrate, dhe te paguaje detyrimet per uje dhe energji elektrike .

Qeramarresi merr persiper te mirembaje ambientin, te mos beje ndryshime strukturore pa miratimin e pales qeradhenese

MARDHENIET ME TE TRETET

NENI 7

Per periudhen e kontraktimit kjo kontrate mbetet ne fuqi ndaj cdo personi te trete qe ka fituar pronesine pas dates se lidhjes se kesaj kontrate cilado qofte forma e fitimit te pronesise.

Qeramarresi nuk ka te drejte te hyje ne mardhenie kontraktore me te tretet per te dhene ambientin ose nje pjese te tij me nenqera .

MBARIMI I KONTRATES

NENI 8

Ne kushte normale kjo kontrate pushon se vepruari me mbarimin e afatit te parashikuar ne te. Me mbarimin e afatit te kontrates qeramarresi ia dorezon objektin ne gjendjen qe e ka marre ne dorezim .

ZGJIDHJA E KONTRATES

Ne rast palet kontraktuese do te kerkojne prishjen e kontrates, ne cdo rast perpara afatit te percaktuar ne kete kontrate, pala qe kerkon prishjen e saj duhet te njoftoje palen tjeter te pakten 90 (nentedhjete dite) kalendarike perpara dates qe kerkon per zgjidhjen e kontrates.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet e mundeshme qe mund te lindin do te zgjidhen me kjo , mosmarreveshjet zgjidhen ne rruge gjyqesore ne gjykaten e rrethit gjyqesor Tirane(Kopetenca Teritoriale)

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje dhe pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te lire dhe te plote te paleve u nenshkrua prej tyre para meje Noteres dhe une e vertetoj sipas ligjit.

QERADHENESI **QERAMARRESI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr.6015**.....Rep. Nr.**2611**.....Kol.**

KONTRATE QERAJE
(Bazuar ne nenin 801 e vijues te K.Civil)

Sot me daten 0_/10/2014 (dymije e katermbedhjete), dite e hene, para meje noteres Majlinda E.Demollari notere me zyre ne Tirane, u paraqiten personalisht:

QERADHENESI

Nafije Elezi,e bija e Bajramit dhe Serme, lindur me 03.12.1955, ne Plani Bardhe, Burrel, banuese ne Rrugen Pavarsia, godina 2-kateshe, Mezes, Tirane km 1 ne autostraden Tirane-Durres, shtetase shqiptare , mbajtes i kartes se identitetit me numer 02631977, leshuar nga autoritetet shqiptare, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, qe me poshte ne kete kontrate do te quhet „Qeradhenesi"

QERAMARRESI

Shoqeria NOVAMAT SHPK", me NIPT:K81615002O, me seli ne Tirane, ne adresen Rr.Ismail Qemali, kulla Fratari no.27, perfaqesuar nga administratori **Mehmet Krasniqi**, shtetas Kosovar, i biri i Tefikut dhe Nexhmije , lindur me 14.08.1973 Prishtine, banues ne Rr.Eduard Mano Liqeni i Thate, Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes se Republikes se Kosoves me numer **K00150716** , dhe qe me poshte ne kete kontrate do te quhet **"Qeramarresit"**

Pala e trete
Shoqeria ME INDUSTRIESOLUTION SHPK", me NIPT:L31325007A, me seli ne Tirane, ne adresen Rr.Teodor Keko, Pallatet Romario , Komuna Yzberisht, Kashar, perfaqesuar nga administratori **Erjon Ahmeti** shtetas Shqiptar, i biri Bilal dhe Hanife, lindur me Verve, Sarande banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit se Republikes se Shqiperise me numer **026045898**, dhe qe me poshte ne kete kontrate do te quhet **"Qeramarresit"**

NENI 1 Objekti

1.1 Qeradhenesi jep me qera godinen e ndertuar si pershkruhet edhe me poshte, sipas lejese se ndertimit me numer prot. 2892 leshuar me dt.15.10.2010, qe eshte ndertuar mbi pronen e paluajtshme "are" e cila eshte regjistruar ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Tirane, me nr.pasuerie 41/13/2 dhe Zonen Kadastrale 2679, Volumi 18, fq.68.Ky object ndodhet ne adresen, Mezez-Koder, Tirane, Rr."Pavaresia" km 1, autostrada Tirane-Durres.

NENI 2 Dispozita te pergjithshme

2.1 Qeradhenesi ka ne pronesi te tij godinen e ndertuar sipas lejes se ndertimit me nr.prot.2892, mbi pronen private te Nafije Elezit, e cila vertetohet me Certifikaten e Pronesise te leshuar nga Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Tirane, me nr.pasurie 41/13/2 dhe Zonen Kadastrale 2679, Volumi 18, fq.68.Ky objekt i kesaj kontrate ka ne perberje te tij 2 kate, nje kat perdhe dhe katin e pare, bodrumin, shkallet,ballkonin, 3 tualete, nje depo dhe 3 (tre)dhoma.
Ne total kjo godine ka nje siperfaqe prej 312 metra katror ndertuar ne nje truall me sip.782 metra katror.Godina ku ndodhet objekti I kesaj kontrate, ka ne perberje te saj dhe nje ambjent te jashtem "Parking" I cili ne siperfaqe totale eshte 682 metra katror qe ndodhet ne pjesen e perparme te objektit, ku hyrja mundesohet nga nje porte me structure metalike qe hapet me dore dhe ne pjesen e mbrapme te objektit, e gjitha e shtruar me beton industrial.I gjite oborri I godines eshte ne perdorim te qeramarresve.Objekti I kesaj kontrate perbehet nga 312metra katrore dhe 682 metra katror "Parking"
2.2 Objekti do te perdoret nga qeramarresi ne perputhje me objektin e aktivitetit qe te dy keta te fundit ushtrojne ne baze te Statutit te tyre I cili ka si per qellim imp- eksp materialeve te ndryshme elektrike , hidraulike, mekanike etj ... .

NENI 3 Afati I Kontrates

3.1 Kontrata nenshkruhet me nje afat 5- vjecar e cila do te filloje ne date 01.12.2014 deri ne date 01.12.2019. Pala qeramarrese nese do te kerkoje zgjidhjen e kontrates se qerase pala afatit t percaktuar ne te duhet te njoftoje palen tjeter tre muaj perpara palen qeradhnese.
Pala qeradhenese nuk ka te drejte te zgjdhe kontraten e qerase para afatit kur pala qeramarresee respekton te gjitha kushtet e kontrates per shkak te investimit dhe prishjes s biznesit te pales qeramarrese

NENI 4 Cmimi I qerase dhe Detyrimet tatimore
4.1 Palet bien dakort , qeramarresit detyrohen te paguajne secili per llogari te tij, te qeradhenesi nje qera mujore ne Shumen 750 euro (shtateqind e pesedhjete) dhe ne total 1500 Euro(ne mije e peseqind) te dy se bashku.
Tatimi ne burim 10% do te paguhet nga Qeramarresitsi dhe taksat vendore ndersa tatimi mbi pasurine e ka pala qeradhenese..

NENI 5 Menyra dhe vendi I pageses

5.1 Pagesa do te kryhet nga dt.1(nje) deri ne daten 5(pese) te cdo fillim muaji dhe do te jete e vlefshme per muajin ne vijim.Pagesa do te kryhet nga qeramarresi ne nje llogari bankare qe qeradhenesi do ti diktoje qeramarresit.

Per permbushjen e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo kontrate pergjigjen ne menyre solidare per te gjithe shumen e qerase ne total, **NOVAMAT Shpk** dhe **ME Industriesolution shpk**

NENI 6 Garancia monetare dhe afati I njoftimit per largim nga objekti

6.1 Me nenshkrimin e kesaj kontrate,qiramarresi do te paguaje ne forme garancie vleren monetare qe korrespondon ne vleren e (tre)qerave mujore,pra ne Shumen e 4500 euro e cila do te kthehet ne perfundim te kontrates neqoftese jane permbushur te gjitha detyrimet kontraktore por ne rast se palet bien dakort per rinovim te kontrates se qirase, garancia monetare e paguar nga qeramarresi nuk kthehet nga qiradhenesi,dhe vazhdon te garantoje kontraten e re me te njejtat kushte si kontrata e meparshme.

6.2 Garancia monetare nenkupton dhe I jep te drejte qiramarresit te njoftoje per zgjidhje te njeanshme te kontrates duke njoftuar 3(tre)muaj perpara dates se largimit te tij nga objekti.Ne kete rast,kur njoftohet largimi nga qiramarresi sipas afatit te parashikuar ne kete pike,qiramarresi nuk detyrohet te paguaje per tremuajt ne vijim deri ne largimin e tij nga objekti.Kjo pike nuk perjashton detyrimet e qiramarresit per demshperblim kundrejt qiradhenesit per cdo dem te shkaktuar per faj te tij ne object.

NENI 7 Detyrimet dhe te drejtat e qeradhenesit

7.1Qiradhenesi deklaron se eshte njohur me objektin e veprimtarise se qiramarresit dhe nuk ka asnje kundershtim as tani dhe as nuk do te kete ne te ardhmen.

7.2 Qiradhenesi detyrohet te dorezoje te qiramarresi me nenshkrimin e kesaj kontrate, [illegible] te godines qe eshte objekt I kesaj kontrate.

7.3 Qiradhenesi detyrohet t'I siguroje qiramarresit perdorimin pa pengesa nga shqetesimet dhe pretendimet e mundshme nga te tretet per kete objekt.

7.4 Qeradhenesi garanton se prona te cilen jep me qera me kete kontrate nuk ka asnje te mete ligjore e cila do te mund te shkaktoje nderprerje te aktivitetit tregtar te qeramarresit.Ne cdo rast qe do te paraqiten problem ose te meta qe parashikohen ne kete pike qeradhenesi detyrohet t'i siguroje qeramarresit nje objekt tjeter me te njejtin cmim dhe qe ofron te njejtat sherbime funksionale ose te demshperbleje qeramarresin per cdo dem te shkaktuar dhe per cdo fitim te munguar nga ky dem.

7.5 Ne rast se "qeramarresi" ka permbushur me perpikmeri te gjitha detyrimet e tij sipas kesaj kontrate dhe legjislacioni ne fuqi,qeradhenesi nuk mund te kerkoje ne asnje lloj forme zgjidhjen e parakohshme,pervec rastit kur palet bien dakort sebashku.

7.6 Qeradhenesi detyrohet te riparoje me shpenzimet e veta te gjitha te metat ose demtimet qe mund te shkaktohen ne objekt dhe qe jane sipasoje e punimeve jocilesore te zbatimit te ndertimit te godines.Nqs ka dijeni per keto te meta,duhet menjehere te njoftoje me shkrim qeramarresin.

NENI8

8.1 Qeramarresi detyrohet te perdore objektin,pjese e kesaj kontrate,sipas kushtevetekontrates.
8.2 Qeramarresi detyrohet,pasi e merr ne dorezim te mbaje objektin ne gjendjete mire dhe ta perdore ate ne perputhje me aktivitetin e deklaruar.
8.3Detyrohet gjithashtu,ta mirembaje objektin duke riparuar me harxhimet e veta, prishjet qe mund te shkaktoje si rrjedhoje e ushtrimit te aktivitetit te tij tregtar. Nga kjo pergjegjesi perjashtohen prishje ta po te metat qe rezultojne nga ndertimi me te meta I objektit.
8.4 Qearamarresi per funksionimin normal te aktivitetit te tij ka te drejte qe pas aprovimit me shkrim te qeradhenesit por me shpenzimet dhe pergjegjesine e tij te beje rregullime,ndryshime dhe shtesa te cilat do te kryhen me kusht qe te mos cenohet sigurimi statik I godines dhe te mos ndryshoje ne thelb,destinacioni fillestar funksional I godines.Ne kete rast qeramarresi duhet ti kryeje me kujdes dhe me vemendje duke u konsultuar cdo here me nje inxhinier ndertimi dhe qeradhenesi do te lejohet te kontrolloje ne cdo hap perpikmerine e zbatimit te ketyre punimeve.
8.5 Qeramarresi ngarkohet te paguaje konsumin e energjise elektrike qe nga dita e pare e marrjes ne dorezim te objektit.Keto pagesa do behen ne baze te faturave te energjise elektrike qe do priten cdo muaj per kete objekt.
8.6 Qeramarresi do te furnizohet me uje nga pusi qe ndodhet ne mjedisin e objektit pa matur konsum dhe pa detyrim pagese per kete konsum.Nga I njejti pus do te furnizohet edhe qeradhenesi.Ne rast nevoje per sherbim, riparim apo nderrim pompe ose nje pjese tjeter keto shpenzime do paguhen ne 50 % te tyre nga qeramarresi dhe nga pala e trete e kesaj kontrate.
8.7 Ne rast se qeramarresi do qe te largohet nga objekti para mbarimit te kesaj kontrate atehere ai eshte I detyruar te njoftoje per kete qeradhenesin tremuaj para largimit te tij. Atehere kur qeramarresi permbushdetyrimin e kesaj pike,nuk detyrohet te paguaje qeradhenesin per demshperblim nga fitimi I munguar.

NENI9 Ndryshimet e kushteve te kontrates

9.1Cdo ndryshim ne kushtet e kesaj kontrate mund te behet ne cdo kohe nga palet me miratimin e tyre dhe do te jete vetem me formen e shkruar duke perjashtuar cdo mjet tjeter vertetues akoma edhe ate te besimit.

NENI10 Mospagimi ne afat

10.1 Mospagimi ne afat I qerase mujore per 3 muaj rresht sipas nenit 5 te kesaj kontrate ose mospagimi I qerasemujore per tre muaj rresht I jep te drejten qeradhenesit te denoncoje kontraten dhe ta zgjidh ne menyre te njeanshme.

NENI11 Rinovimi I kontrates

11.1 Mbas mbarimit te afatit te kesaj kontrate palet mund te bien dakort per rinovimin e saj I cili do te kryhet vetem me shkrim.Qeradhenesi ne cdo rast eshte I detyruar te beje kerkese per rinovim kontrate te qeramarresi dhe vetem pasi te marre nga ky I fundit nje pergjigje negative vetem atehere mund tu drejtohet te treteve me te cilet mund te lidhe nje kontrate qeraje per kete

objekt.Njoftimi per rinovim kontrate eshte tremuaj para afatit te mbarimit te kesaj kontrate dhe eshte detyrim per te dyja palet.

11.2 Neqoftese palet bien dakort se kontrata dhe pas njoftimeve te kerkeses se mesiperme nuk do te rinovohet do te lejohet nga qeramarresi vizita ne objektin e dhene me qera ne dite dhe ore pune e te treteve qe deshirojne te marrin me qera ne vazhdim objektin e kesaj kontrate.E njejta praktike do pranohet nga qeramarresi dhe pas lajmerimit per largim sipas nenit 8 te kesaj kontrate.

Neni12 Procesverbal marrje ne dorezim
12.1 Palet hartojne se bashku nje procesverbal te marrjes ne dorezim te objektit ku ne te pasqyrohen te gjitha pjeset perberese te tij cilesia dhe gjendja e tyre aktuale dhe firmoset nga te dy palet. Ky procesverbal I bashkangjitet kesaj kontrate.

NENI13 Dispozitat e fundit

13.1 Palet e kesaj kontrate do te perpiqen ti zgjidhin mosmarrveshjet qe mund te lindin nga kjo kontrate me mirekuptim.Ne rast te kundert konflikti do te zgjidhet nga Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

QERADHENESI
Znj.Nafije Elezi

Nafije Elezi

QERAMARRESI
NOVAMAT Shpk
Adminstratori
Mehmet Krasniqi

Mehmet Krasniqi

PALA E TRETE
ME Industriesolution Shpk
Administrator
Erjon Ahmeti

Erjon Ahmeti

Noterja Marlinda E. Kalaj Rruga Tel.: 2699

SHOQERIA: " NOVAMAT " SHPK **NIPT: K 81615002 O**

Drejtuar: **DREJTORISE RAJONALE TE TATIMEVE TIRANE**

Lenda: **DOREZIM I PASQYRAVE FINACIARE-BILANCI-2014**

Bashkangjitur Ju dergojme:

Pasqyrat Financiare (Bilacin) per vitin 2014 ne dy kopjo origjinale.

Mehmet KRASNIQI

ADMINISTRATOR

Tirane, me 31 Mars 2015

Quality and Safety from one source
NOVAMAT
Sh.p.k
Tirane - Albania